

NAPOLI – Seminario sulla Filologia

Presso il Dipartimento di Studi dell'Europa Orientale dell'Università di Napoli L'Orientale il 30 giugno 2010 si è tenuto un seminario su "Criteri della filologia moderna e concordanza".

La cattedra di Lingua e letteratura albanese, che ha promosso l'evento, da anni è impegnata allo studio e alla pubblicazione di opere inedite e rare per creare un corpus completo di opere in edizione critica. Lo spunto al seminario è stato dato dalla preparazione in atto dell'opera in arbëresh di Francesco Antonio Santori dal titolo "Sofia Cominiata" a cura della Dott.ssa Merita Sauku Bruci, dell'Istituto di Linguistica e Letteratura del Centro di Studi Albanologici di Tirana.

Dopo le operazioni preparatorie che hanno interessato il censimento dei manoscritti e di altri testimoni, conservati in biblioteche pubbliche e private, nello specifico Biblioteca Civica di Cosenza, Biblioteca di Copenhagen, Archivio di Stato di Tirana, e in seguito alla loro descrizione fatta con cura e meticolosità, la filologa Dott.ssa Merita Sauku Bruci ha proceduto ad un esame completo dell'opera, tenendo presente tanto il testo nell'originale albanese quanto quello della traduzione italiana fatta dall'autore stesso.

Prima di procedere alla trascrizione dell'intero testo in arbëresh, e dopo avere individuato i valori fonemici rappresentati dai segni grafici propri del Santori, rendendoli con quelli dell'alfabeto di Monastir con le dovute cautele e aggiustamenti, la curatrice ha premesso un ampio studio introduttivo (i Prolegomeni) in cui ha messo in evidenza forma e contenuto dell'opera.

Di ogni operazione e di ogni intervento è stata data attenta giustificazione e documentazione, così come di ogni correzione di eventuali lapsus calami esiste il necessario riferimento alla forma considerata errata. Questo per permettere ad eventuali altri filologi di avere un quadro esauriente e documentato degli interventi e di procedere, eventualmente, ad altri approfondimenti o miglioramenti qualora ne fosse bisogno. La relativa documentazione appare nei Prolegomeni ma anche, in maniera più precisa, nell'apparato critico.

Al seminario ha partecipato, oltre alla Dott.ssa Merita Sauku Bruci e al Prof. Italo Costante Fortino, la Prof.ssa Maddalena Toscano, dell'Orientale di Napoli, la quale ha messo in luce l'utilità della "concordanza" e la sua applicazione al testo di qualsiasi lingua.

La Toscano in primis ha spiegato alcuni aspetti particolari del funzionamento del programma "Concordance" che è consigliato per la sua flessibilità e adattabilità.

Nel caso specifico dell'albanese è stato ricordato che, dopo avere risolto il problema dei riferimenti dei singoli lemmi che devono essere dati al programma per l'elaborazione automatica di gran parte del materiale preso in esame, necessita un intervento manuale per la lemmatizzazione delle forme e un parziale intervento relativo alla sistemazione dell'ordine alfabetico.

La Prof.ssa Toscano ha affermato, infine, che la codificazione finale della concordanza relativa al romanzo "Sofia Cominiata" è opportuno eseguirla nel "CILA", il Centro e Laboratorio linguistico dell'Orientale, bene attrezzato e autorizzato all'uso del programma "Concordance".

In tal modo l'edizione critica, che prende in considerazione anche la concordanza, diventa un contributo alla lessicografia e la base per ulteriori studi sulla lingua dell'autore.

NAPOLI – Seminar për Filologjinë

Më 30 qershor 2010, në një nga auditoret e Departamentit të Studimeve të Europës Lindore të Universitetit të Napolit "L'Orientale", u zhvillua një seminar mbi "Kriteret e filologjisë moderne dhe konkordancat".

Katedra e Gjuhës dhe Letërsisë shqipe e këtij universiteti, organizatore e seminarit, prej vitesh punon në lëmë të studimit dhe botimit të veprave të pabotuara e të rralla, për të krijuar një korpus të plotë të veprave letrare në botim kritik. Si shtysë për të organizuar një seminar të tillë shërbeu përgatitja për botim e veprës në arbërisht të Frangjisk Anton Santorit me titull "Sofia Cominiata",

përgatitur nga Dr. Merita Sauku Bruçi, e Institutit të Gjuhësisë dhe Studimeve Letrare të Qendrës së Studimeve Albanologjike në Tiranë.

Pas kërkimeve dhe punëve përgatitore lidhur me gjetjen dhe grumbullimin e dorëshkrimeve dhe kopjeve të tjera që gjenden në biblioteka publike e private, si Biblioteka Qytetëse e Kozencës, Biblioteka Mbretërore e Kopenhagenit, Arkivi i Shtetit (Tiranë), dhe pas përshkrimit të dorëshkrimeve të bëra me kujdes dhe hollësi, Dr. Merita Sauku Bruçi, ka vijuar me shqyrtimin e plotë të veprës, tuke u mbështetur si në tekstin origjinal të shkruar në arbërisht, ashtu edhe në përkthimin në italisht të bërë nga vetë autori.

Pasi ka saktësuar vlerat e fonemave të paraqitura me shenja grafike të krijuara nga vetë Santori, përgatitësja e botimit ka kryer transkriptimin e të gjithë tekstit në arbërisht, duke përdorur alfabetin e Manastirit, me kujdesin dhe rregullimet e duhura. Një studim i gjerë hyrës (Prolegomenat), ku janë vënë në dukje forma dhe përmbajtja e veprës, paraprin transkriptimin e tekstit. Çdo veprim dhe çdo ndërhyrje nga ana e Bruçit, është shpjeguar dhe dokumentuar me kujdes, po kështu edhe në rastet kur kemi të bëjmë me gabime të pavullnetshme të vetë autorit (lapsus calami) është dhënë sinjalizimi i duhur për koregjimet e formës që konsiderohet si e gabuar. Kjo u lejon filologëve të tjerë që të kenë një kuadër të plotë dhe të dokumentuar të ndërhyrjeve të kryera nga përgatitësja e botimit, si edhe të thellohen apo të përmirësojnë një punë të tillë nëse del e nevojshme.

Në seminar përveç Dr. Merita Sauku Bruçi dhe prof. Italo Kostante Fortino mori pjesë edhe prof. Maddalena Toscano, e “L’Orientale”-s së Napolit, e cila vuri në dukje nevojën e “Konkordancave” në një botim kritik si dhe larminë e përdorimit edhe në fusha të tjera të studimit apo për tekste të gjuhëve të ndryshme.

M. Toskano së pari shpjegoi disa aspekte të veçanta të funksionimit të programit “Concordance”, që është i këshillueshëm për vetë fleksibilitetin dhe përshtatshmërinë që ka.

Në rastin e gjuhës shqipe u tërhoq vëmendja, se pasi të jetë zgjidhur problemi i referimeve në tekstin origjinal të secilit përdorim të një leme të caktuar, pas përpunimit kompiuterik të tekstit të dhënë, nevojitet edhe një ndërhyrje e përgatitësit të botimit, për lematizimin e formave dhe renditjen alfabetike sipas alfabetit të shqipes.

Prof. Toskano rekomandoi së fundmi, që kodifikimi përfundimtar i konkordancave të romanit “Sofia Cominiate” të bëhet pranë “CILA” (Qendra dhe Laboratori i kërkimeve gjuhësore të Universitetit “L’Orientale), e cila është e mirëpajisur dhe e autorizuar për përdorimin e programit “Concordance”

Kështu që botimi kritik, i pajisur edhe me konkordancat e veprës, shënon njëkohësisht edhe një kontribut për leksikografinë dhe një bazë të mirë për studime të mëtejshme të gjuhës së autorit në fjalë.